

**Video e Sekretarit Kerry**  
**Samiti Global i Rrjetit të qyteteve të forta**  
**Incizuar më 31 maj 2016 për uebsajtin e qyteteve të forta**

Përgëzoj Rrjetin e qyteteve të forta për inaugurimin shumë të suksesshëm të Samitit Global, të mbajtur në Antalia më 11 maj. Posaçërisht falënderoj ministrin turk të Punëve të Jashtme Cavusoglu dhe kryetarin e Antalias Turel për vizionin dhe punën e tyre të zellshme në organizimin e kësaj ndodhie – dhe gjithashtu falënderoj shumë kryetarë komunash, udhëheqës të tjerë komunalë dhe përfaqësues të shoqërisë civile të cilët erdhën nga tërë bota për të marrë pjesë.

Uniteti është thelbësor në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm; të gjithë e dimë këtë. Terroristët mund të shfaqen në çdo vend dhe rrenat që i propagandojnë shpejt mund t'i rrethojnë kufijtë nacionalë. Përmes tubimeve globale, si ky Samit, punëtorive rajonale dhe shkëmbimit të vazhdueshëm të informatave dhe ideve, Rrjeti i qyteteve të forta mund të na ndihmojë në zbatimin e praktikave më të mira për t'iu përgjigjur një kërcënimi që na rrezikon të gjithëve.

Samiti i 11 majit paraqiti dëshmi dramatike nga të mbijetuarit e sulmeve terroriste, nga ish-anëtarët e grupeve të dhunshme ekstremiste dhe nga udhëheqësit komunalë të cilët i kanë mbajtur komunitetet e tyre bashkë përkundër përpjekjeve të radikalëve për të mbjellë përçarje. Porosia e batur ishte e fortë – për vendosmëri, aftësi ripërtëritëse, zotim për pluralizëm dhe respektim të të drejtave dhe dinjitetit që çdo njeriu.

Tema kryesore e Samitit ishte imperativë për të gjithë ne për të punuar së bashku – përtej kufijve politikë, por edhe përtej linjave fetare, përtej ndarjes mes lokales dhe kombëtares dhe përtej ndarjes mes sektorit publik dhe privat. U tërhoq vëmendja për programet e medieve sociale, si Shoku-shokut, të cilat u mundësojnë nxënësve dhe studentëve kudo të krijojnë iniciativa të veta të porosive dhe në këtë mënyrë i inkurajojnë të rinjtë që ta kanalizojnë energjinë dhe aktivizmin e tyre në mënyra paqësore dhe produktive.

Rrjeti i qyteteve të forta është gjithashtu, siç thotë edhe vetë emri, duke i bashkuar disa prej qendrave tona të mëdha urbane për t'i ndarë mësimet e nxjerra përmes shkëmbimit të personelit dhe krahasimit të përvojave të kaluara dhe të sfidave aktuale. Qeveria e Danimarkës, për shembull, ka filluar shkëmbime me qytetin e Amanit, Bejrutit dhe Tunisit për ta ndihmuar ndërtimin e kapaciteteve për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm në zona kritike.

Inkurajoj udhëheqësit e të gjitha qyteteve dhe qeverive subnacionale që i janë bashkuar Rrjetit të qyteteve të forta të marrin pjesë në mënyrë aktive në përpjekjet e saj. Kërkoj nga ata që ende nuk janë bashkuar ta kenë parasysh bashkimin. Me këtë zgjedhje, ju do të futeni në një fushatë që po zgjerohet shpejt për t'i sulmuar shkaqet kryesore të ekstremizmit të dhunshëm. Ju do të gjeni ndihmë në ndërmarrjen e hapave praktikë për ta mbrojtur sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve tuaj. Ju mund ta tregoni mbështetjen tuaj për vlerat e mirësjelljes dhe të respektit të ndërsjellë që janë thelbësore për përparimin ekonomik e social dhe që janë në zemër të vetë civilizimit.

Ju faleminderit dhe urimet më të mira për të gjithë ju.

#####